



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.320/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjor Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Alenca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Alenca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të dt. 22.10.2017.

### A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AAK, dega në Mitrovicë me të cilën pretendon se aktivist të subjektit politik LDK, pas shkollës SH.F.M.U” Fazli Grajçevci” në Mitrovicë kanë shpërndarë fletushka të kandidatit për kryetar të Komunës së Mitrovicës, nga radhët e po të njëjtit subjekt politik, Safet Kamberi.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 2 fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik LDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e LZP-së, për arsye se nga fotografitë e ofruara si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore pasi që nuk mund të identifikohet koha dhe data e bërjes së të njëjtave dhe në mungesë dëshmime të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL. Anr.320/2017 më datën 22.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltenë Sylejmani



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*